128

SIGURI
ENERGJI
ZHVILLIM

PROGRAMI I ALEANCËS
2026 - 2030

*Zgjedhjet parlamentare — **7 qershor 2026***

Ardian Gjini
Kandidat për Kryeministër

128

SIGURI
ENERGJI
ZHVILLIM

PËRMBAJTJA

- Letër qytetarëve të Kosovës
- Prioritetet Programore (2026–2030)
- Siguria Strategjike dhe Partneriteti Ndërkombëtar
- Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat
- Siguri Energjetike dhe Infrastrukturë Moderne
- Edukimi Profesional dhe Lidhja e Arsimit me Tregun
- Rritje Ekonomike si Bazë për Politikën Sociale
- Shëndetësi e Siguruar dhe Shërbime me të Vërtetë Falas

Të dashur qytetarë,

Kosova ndodhet në një moment vendimtar. Pas shumë vitesh tensione politike, stagnimi ekonomik dhe krizash të panevojshme institucionale, qytetarët kanë humbur besimin se shteti mund të funksionojë seriozisht, me stabilitet dhe me vizion afatgjatë.

Për vite me radhë, politika është konsumuar në konflikte të brendshme, propagandë dhe polarizim. Ndërkohë, familjet janë përballur me rritje të kostos së jetesës, pasiguri ekonomike, mungesë perspektive për të rinjtë dhe dobësim të shërbimeve publike. Shumë qytetarë sot nuk kërkojnë më premtime të mëdha; kërkojnë shtet funksional, institucione serioze dhe qeveri që punon.

Kosova nuk ka nevojë për një tjetër cikël krizash politike. Ka nevojë për drejtim. Ka nevojë për stabilitet. Ka nevojë për zhvillim.

Prandaj ky program nuk është ndërtuar si listë premtimesh elektorale. Ky është një plan qeverisës për transformimin ekonomik, institucional dhe strategjik të Republikës së Kosovës gjatë viteve 2026–2030.

Ky program mbështetet mbi tri shtylla themelore:

SIGURIA, *si parakusht për shtet të fortë dhe ekonomi stabile;*

ENERGJIA, *si bazë e zhvillimit industrial dhe pavarësisë ekonomike;*

ZHVILLIMI, *si rezultat i punës, investimeve dhe institucioneve funksionale.*

Ne besojmë se Kosova mund të bëhet shtet modern evropian vetëm nëse ndërton ekonomi prodhuese, administratë profesionale, drejtësi funksionale, arsim të lidhur me tregun, dhe partneritet të fortë me SHBA-në, NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

Për të jetësuar këtë vizion, planprogrami ynë zbërthehet në 6 SHTYLLAT STRATEGJIKE TË PROGRAMIT TONË:

1. ***Siguria Strategjike dhe Partneriteti Ndërkombëtar***
2. ***Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat***
3. ***Siguri Energjetike dhe Infrastrukturë Moderne***
4. ***Edukimi Profesional dhe Lidhja e Arsimit me Tregun***
5. ***Rritje Ekonomike si Bazë për Politikën Sociale***
6. ***Shëndetësi e Siguruar dhe Shërbime me të Vërtetë Falas***

Ky është vizioni ynë për Kosovën: jo shtet i krizave të përhershme, por shtet i sigurisë, zhvillimit dhe besimit.

***Më 7 qershor**, ju e keni në dorë të zgjidhni midis atyre që vazhdojnë të ushqehen me urrejtje e fyerje, dhe rrugës tonë, rrugës së punës, qetësisë dhe vizionit afatgjatë.*

Unë jam gati. Aleanca është gati.

*Për **SIGURI, ENERGJI, ZHVILLIM**, gjithmonë për Kosovën që e duam me gjithë zemër. Për Andrrën e Kosovës tonë të jashtëzakonshme.*

Na priftë e mbara!

Ardian Gjini
Kryetar i Aleancës dhe
Kandidat për Kryeministër

PRIORITETET PROGRAMORE (2026–2030)

Aleanca prezanton planprogramin e saj qeverisës, i cili reflekton një qasje të re sovrane për Republikën e Kosovës. Ne besojmë se vendi nuk mund të qeveriset më me politika reaktive apo premtime afatshkurtra. Ky program është një zotim për transformim rrënjësor, i udhëhequr nga tri parimet tona bazë: ***SIGURIA, ENERGJIA dhe ZHVILLIMI.***

Për rrethanat e reja gjeopolitike dhe ekonomike, oferta jonë ofron zgjidhje të guximshme të strukturuara në gjashtë shtylla kryesore strategjike:

Siguria Strategjike dhe Partneriteti Ndërkombëtar

Çka ndryshojmë: Kosova kalon nga një politikë reaktive e varur nga dialogu me Serbinë, në një doktrinë të pavarur sovrane. Zhvillimi ynë institucional dhe ekonomik do të ecë përpara pa u mbajtur peng i njohjes nga Beogradi.

Veprimet kryesore: Ndërtimi i një mjedisi të sigurt gjeostrategjik për investitorët e huaj përmes marrëdhënieve të drejtpërdrejta me SHBA-në, NATO-n dhe BE-në. Kalojmë nga marrëveshjet formale me Shqipërinë në një integrim të plotë institucional dhe tregtar. Mobilizojmë kapitalin e diasporës përmes instrumenteve të sigurta financiare shtetërore (Obligacioneve për Zhvillim).

Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat

Çka ndryshojmë: Sektori privat trajtohet si motori kryesor i punësimit, jo si burim i thjeshtë taksash. Drejtësia nuk do të jetë më pengesë për biznesin, por mbrojtëse e tij.

Veprimet kryesore: Nënshkrimi i një Pakti të Ri me bizneset që ul barrën tatimore dhe eliminon burokracinë. Reformojmë drejtësinë komerciale për të shkurtuar afatet gjyqësore për kontestet ekonomike. Funksionalizojmë të gjitha asetet e pashfrytëzuara të shtetit për hapjen e vendeve të reja të punës, duke garantuar paralelisht zbatimin rigoroz të Ligjit të Punës dhe kushte dinjitoze.

Siguri Energjetike dhe Infrastrukturë Moderne

Çka ndryshojmë: Energjia trajtohet si çështje e sigurisë kombëtare. Prodhimi dhe industria vendore nuk do të lihen më në mëshirë të importit të shtrenjtë apo krizave të paparashikueshme të mbylljes.

Veprimet kryesore: Garantojmë furnizim të qëndrueshëm dhe çmime të parashikueshme përmes diversifikimit të burimeve dhe investimeve strategjike. Ndërtojmë një rrjet modern rrugor dhe lidhje logjistike si instrumente të pastra ekonomike që ulin koston e transportit dhe rrisin drejtpërdrejt konkurrueshmërinë e prodhuesve tanë në tregun rajonal dhe evropian.

PRIORITETET PROGRAMORE (2026–2030)

Edukimi Profesional dhe Lidhja e Arsimit me Tregun

Çka ndryshojmë: Ndërpresim prodhimin e diplomave pa mbulesë dhe të papunësisë kronike. Sistemi arsimor reformohet për të krijuar aftësi praktike që kërkohen nga ekonomia reale.

Veprimet kryesore: Riorganizojmë shkollat profesionale, universitetet dhe programet e trajnimit duke i lidhur ato direkt me nevojat e bizneseve. Investimet strategjike në edukim do të orientohen ekskluzivisht drejt sektorëve me potencialin më të lartë të rritjes: prodhim, teknologji e informacionit, energji, ndërtim, shërbime dhe eksport.

Rritje Ekonomike si Bazë për Politikën Sociale

Çka ndryshojmë: Skemat sociale nuk do të trajtohen më si lëmoshë apo mjete për varësi afatgjatë, por si një urë drejt dinjitetit ekonomik dhe punësimit. Ne do të kalojmë nga mbështetja pasive në politika aktive që e mbrojnë familjen nga inflacioni dhe rritja e kostos së jetesës.

Veprimet kryesore: Rritim pensionet dhe mbështetjen sociale në mënyrë të rregullt, duke e lidhur rritjen direkt me trajektoren e zhvillimit ekonomik dhe indeksin e inflacionit, në mënyrë që paraja e pensionistëve të mos humbë vlerën. Mbështetja e shtetit do të fokusohet te mbrojtja e shtresave në nevojë të cilat nuk mund të punojnë, ndërsa për qytetarët e aftë për punë do të krijohen pako subvencionimi për bizneset që i punësojnë ata, duke i integruar me dinjitet në tregun e punës.

Shëndetësi e Siguruar dhe Shërbime me të Vërtetë Falas

Çka ndryshojmë: Familja kosovare nuk do të falimentojë më për t'u shëruar. Shëndetësia publike kthehet në shtyllë të sigurisë familjare.

Veprimet kryesore: Funksionalizojmë Fondin e Sigurimeve Shëndetësore që në vitin e parë të mandatit. Heqim çdo tarifë bazë apo participim për shërbimet esenciale dhe garantojmë barnat esenciale falas gjatë mjekimit. Ky model do të shtrihet në tri nivele duke garantuar mjekun e familjes për çdo shtëpi, autonomi financiare për spitalet rajonale dhe digjitalizim të plotë përmes Sistemit të Informacionit Shëndetësor (SISH).

Siguria Strategjike dhe Partneriteti Ndërkombëtar

SIGURI

Siguria Strategjike dhe Partneriteti Ndërkombëtar

Siguria është shtylla e parë e programit tonë, sepse pa siguri nuk ka zhvillim ekonomik, nuk ka investime serioze dhe nuk ka stabilitet institucional. Aleanca e vendos Kosovën në një qasje të re sovrane gjeopolitike, ku kërcënimet nuk maten më vetëm me rreziqe ushtarake klasike. Sot, siguria e shtetit dhe e familjes kërcënohet nga sulmet hibride, kibernetike, energjetike, informative dhe ekonomike. Për këtë arsye, siguria trajtohet si politikë kombëtare e ndërlidhur dhe jo si përgjegjësi e izoluar e një ministrie.

Orientimi ynë strategjik është anëtarësimi i shpejtë dhe direkt i Republikës së Kosovës në NATO, përmes rikthimit të plotë të partneritetit me aleatët tanë gjeostrategjikë, me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne e shohim NATO-n jo vetëm si garanci ushtarake, por si një platformë që rrit besueshmërinë e shtetit, ul rrezikun politik për investitorët e huaj dhe e rreshton Kosovën krah demokracive perëndimore. Rrugëtimi ynë zhvillimor nuk do të mbahet më peng i dialogut apo i njohjes nga Serbia; Kosova do të ndërtojë kapacitetet e saj sovrane duke u integruar në strukturat euro-atlantike si një subjekt i pavarur dhe kontribuues në sigurinë rajonale.

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës do të ndërtohet mbi koordinim të plotë me aleatët strategjikë, forcim të subjektivitetit ndërkombëtar dhe integrim euro-atlantik. Anëtarësimi në NATO, Bashkimin Evropian dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara trajtohen si objektiva të ndërlidhura me sigurinë kombëtare, zhvillimin ekonomik dhe besueshmërinë ndërkombëtare të shtetit. Kosova duhet të projektojë stabilitet, partneritet dhe qartësi strategjike në raport me botën demokratike perëndimore.

Për të jetësuar këtë vizion, Aleanca zotohet për realizimin e këtyre masave konkrete gjatë mandatit 2026–2030:

1. Mbrojtja Kombëtare, Buxheti dhe Modernizimi i FSK-së

Financim rekord në nivele të NATO-s: Do të sigurojmë mbi 2.2 miliardë euro për mbrojtje gjatë mandatit katërvjeçar, duke rritur buxhetin në nivelet më të larta strategjike për të garantuar pavarësi operative dhe seriozitet përpara aleatëve.

Përmbyllja e Tranzicionit të Ushtrisë: Do të përmbyllim me sukses të plotë Planin e Tranzicionit të FSK-së dhe do të nisim menjëherë planifikimin e ri për një ushtri inteligjente, të pajisur me teknologji moderne, të aftë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe për operacione të përbashkëta me NATO-n.

Themelimi i "Heliko-Parkut": Do të krijojmë njësinë e parë ajrore kombëtare me 8 helikopterë në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila do të jetë në shërbim të mbrojtjes, Policisë së Kosovës, emergjencave civile dhe protokollit shtetëror.

Zhvillimi i Industrisë së Mbrojtjes: Do të miratojmë legjislacionin e posaçëm për fillimin e prodhimit vendor të municioneve, predhave dhe dronëve. Do të krijojmë lehtësira doganore dhe administrative për "Mallrat Strategjike", duke u hapur dyert investitorëve ndërkombëtarë dhe vendorë për dizajnuesit e pajisjeve të sigurisë.

Edukimi i Rinisë për Mbrojtje dhe Solidaritet: Do të fillojmë programin kombëtar vullnetar për edukimin e të rinjve të moshës 18-25 vjeç përmes kampeve sezonale (pranverore, verore, vjeshtore, dimërore), duke i aftësuar ata për reagim në raste krizash, fatkeqësish natyrore dhe në mbështetje të njësive të shpëtimit.

Siguria Strategjike dhe Partneriteti Ndërkombëtar

2. Partneriteti Strategjik dhe Diplomacia e Sigurisë

Rikthimi i Dialogut Strategjik me SHBA-në: Do të rifillojmë Dialogun Strategjik Kosovë-SHBA si boshtin e pacenueshëm të politikës tonë të jashtme, mbrojtjes dhe orientimit euro-atlantik.

Diplomacia aktive për integrim euro-atlantik: Do të hartojmë dhe zbatojmë Planin Kombëtar për anëtarësim në BE, NATO dhe organizata ndërkombëtare, duke koordinuar diplomacinë politike, ekonomike dhe publike me partnerët strategjikë të Kosovës.

Diplomacia me vendet njohëse dhe jonjohëse: Do të zhvillojmë diplomaci të koordinuar kulturore, ekonomike dhe parlamentare për zgjerimin e njohjeve dhe forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës.

Nation Branding dhe diplomacia ekonomike: Do të ndërtojmë strategji shtetërore për promovimin e Kosovës si vend demokratik, stabil, investues dhe turistik, duke përfshirë diasporën, kulturën, sportin dhe potencialin ekonomik të vendit.

KIDA dhe profesionalizimi diplomatik: Do të themelojmë Agjencinë e Kosovës për Zhvillim Ndërkombëtar dhe do të reformojmë shërbimin diplomatik përmes Ligjit të ri për Diplomacinë dhe trajtimit dinjitoz të diplomatëve.

Zyrë Ndërlidhëse dhe Dialog i Dizajnuar me NATO-n: Do të ndërtojmë një platformë të re integruese për të hapur një Zyrë Ndërlidhëse zyrtare të NATO-s në Prishtinë, duke thelluar paralelisht stërvitjet, trajnimet dhe ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta me KFOR-in.

Mbrojtja e Mençur Rajonale: Do të ndërtojmë një platformë të përbashkët me shtetet aleate në rajon, me theks të veçantë në integrimin e plotë institucional, tregtar dhe të sigurisë me Republikën e Shqipërisë, për të krijuar një hapësirë të unifikuar strategjike.

Dialogu me Serbinë: Do të zhvillohet në koordinim të plotë me SHBA-në dhe BE-në, me synim marrëveshje përfundimtare me njohje reciproke dhe integrim të plotë ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Procesi i dialogut nuk duhet të prodhojë bllokadë të pafundme politike, por stabilitet afatgjatë dhe siguri rajonale.

3. Siguria Publike, Policia dhe Mirëqenia e Profesionistëve

Shtimi i Forcave Policore: Do të rekrutojmë 1,000 policë të rinj gjatë mandatit dhe do të realizojmë një riorganizim të brendshëm struktural, duke transferuar kuadrin civil në punë administrative për të rritur praninë dhe shpejtësinë e reagimit policor në terren.

Pakoja e Sigurimit për Policinë: Do të funksionalizojmë menjëherë pakon e plotë ligjore që garanton Sigurimin Shëndetësor, Sigurimin Jetësor, si dhe mbulimin e plotë të shpenzimeve të udhëtimit dhe të ushqimit për çdo zyrtar policor.

Reforma për Zjarrfikësit Shpëtues: Do të kalojmë në një model të centralizuar të menaxhimit të zjarrfikësve me protokolle të unifikuara në të gjitha komunat. Do të ulim moshën mesatare përmes rekrutimeve të reja, do të modernizojmë pajisjet dhe do të paguajmë plotësisht të gjitha shtesat e rrezikshmërisë.

Siguria Strategjike dhe Partneriteti Ndërkombëtar

Garantimi i Dinjitetit në Punë: Do të realizojmë rritjen e rregullt vjetore të pagave, mundësive të karrierës dhe kushteve të punës për të gjithë shërbyesit në sektorin e sigurisë, si masa kryesore për të parandaluar ikjen e profesionistëve nga vendi.

4. Rezilienca Kombëtare, Mbrojtja Kibernetike dhe Kërcënimet Hibride

Arkitektura e Mbrojtjes Kibernetike: Do të funksionalizojmë Agjencinë e Sigurisë Kibernetike si mekanizmin civil kryesor për promovimin dhe mbrojtjen e rrjeteve publike, sistemit bankar dhe operatorëve privatë. Paralelisht, do të themelohet Qendra Ekselente e Mbrojtjes Kibernetike për të thithur ekspertizën më të mirë në rajon.

Përballja me Luftën Hibride dhe Dezinformimin: Do të forcojmë Agjencitë e Inteligjencës (përfshirë krijimin e Agjencisë së Inteligjencës për Mbrojtje) dhe do të funksionalizojmë një njësi të specializuar për koordinimin e luftës kundër dezinformimit, propagandës dhe ndikimeve të huaja armiqësore.

Siguria Publike përmes Teknologjisë: Do të garantojmë autonomi të plotë operacionale për Policinë e Kosovës dhe do të investojmë në investime teknologjike, duke përfshirë mbulimin inteligjent të akseve rrugore me kamera, si dhe reformimin e bashkëpunimit mes Policisë, Prokurorisë dhe Gjyqësorit për luftimin e krimit dhe korrupsionit.

Infrastruktura e Sigurisë Kombëtare: Do të hartohen dhe zbatohen programe të veçanta për sigurinë energjetike, ujore, mjedisore dhe ajrore. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme do të përshtatin dhe modernizojnë hapësirat nëntokësore dhe publike në strehimore funksionale për menaxhimin e emergjencave civile.



Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat

ZHVILLIM

Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat

Zhvillimi ekonomik është boshti që e lidh mirëqenien e qytetarit me funksionimin dhe stabilitetin e shtetit. Për një kohë të gjatë, ekonomia e Kosovës ka qenë e varur në mënyrë të paqëndrueshme nga konsumi, importi i lartë dhe remitencat, duke lënë vendin me një deficit të thellë tregtar dhe mungesë të fuqisë punëtore pas largimit të të rinjve. Aleanca propozon një kthesë rrënjësore: kalimin e menjëhershëm nga ekonomia e konsumit pasiv drejt një ekonomie të bazuar në prodhim, eksport, investime kapitale dhe punësim me dinjitet.

Ky transformim nuk mund të arrihet pa një shtet të së drejtës, institucione funksionale dhe administratë profesionale. Sundimi i ligjit dhe drejtësia efikase janë parakushtet kryesore për të kthyer besimin e investitorëve të huaj dhe kapitalit vendor. Një shtet që nuk respekton institucionet e veta, që politizon administratën dhe që e kthen vendimmarrjen në konflikt të vazhdueshëm, nuk mund të prodhojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Aleanca do ta trajtojë sektorin privat si motorin kryesor të zhvillimit, duke ndërtuar një pakt të ri mes shtetit dhe biznesit, ku institucionet nuk shërbejnë si pengesë burokratike, por si mbrojtëse dhe partnere të kapitalit.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të trajtohet si obligim institucional dhe jo si propagandë politike. Përmes prokurimit transparent, kodeve të avancuara të etikës, mbikëqyrjes së pavarur dhe forcimit të institucioneve të drejtësisë, do të krijohet një ambient i drejtë ekonomik ku konkurrenca mbështetet në meritë dhe jo në klientelizëm. Fuqizimi i institucioneve të pavarura, mbrojtja e lirisë së medies dhe konsultimi me shoqërinë civile, bizneset dhe komunat do të jenë pjesë e modelit të ri të qeverisjes së hapur dhe të përgjegjshme.

Digjitalizimi i administratës dhe avancimi i e-qeverisjes do të shërbejnë si mekanizma për uljen e burokracisë, rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit në institucione. Qytetarët dhe bizneset nuk duhet të humbin kohë në procedura të panevojshme administrative. Për këtë arsye, Aleanca do të zhvillojë platforma moderne digjitale për ofrimin e shërbimeve publike, monitorimin e shpenzimeve shtetërore dhe menaxhimin e identitetit digjital dhe infrastrukturës së domenit shtetëror të Republikës së Kosovës.

Për mandatin qeverisës 2026–2030, Aleanca zotohet për realizimin e këtyre masave konkrete:

1. Pakti i Ri me Sektorin Privat dhe Reformat Tatimore

Ulja e barrës tatimore dhe administrative: Do të rishikojmë kornizën fiskale për të lehtësuar bizneset prodhuese dhe eksportuese, duke thjeshtuar procedurat e deklarimit dhe duke eliminuar barrierat burokratike që rrisin koston e bërjes biznes, përmes masës konkrete të ngritjes së pragut për deklarimin e TVSH-së nga 30,000 euro në 100,000 euro, duke liruar mijëra biznese të vogla dhe të mesme nga kjo barrë.

Mbështetje direkte për Start-up-et dhe NVM-të: Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme do të përfitojnë nga paketa të veçanta të granteve dhe subvencioneve shtetërore, me fokus parësor projektet inovative që nisen nga fillimi (start-up) në fushën e teknologjisë dhe prodhimit.

Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat

Funksionalizimi i aseteve të shtetit: Të gjitha asetet publike dhe pronat e pashfrytëzuara në pronësi të shtetit do të vihen në funksion të zhvillimit ekonomik përmes partneriteteve publike-private, duke hapur zona të lira ekonomike që gjenerojnë vende të reja pune.

Zbatimi i Ligjit të Punës: Paralelisht me mbështetjen për bizneset, do të garantojmë kushte dinjitoze, siguri në punë dhe respektim të plotë të drejtave të punëtorëve në sektorin privat përmes fuqizimit të Inspektoratit të Punës.
Garantojmë zbatimin e prerë të javës 5-ditëshe të punës në të gjithë sektorët, duke mbrojtur të drejtat dhe pushimin e punëtorëve.

2. Drejtësi Efikase dhe Siguri për Kapitalin

Reformimi i Drejtësisë Komerciale: Do të propozojmë ndryshime ligjore për të shkurtuar radikalisht afatet gjyqësore për kontestet ekonomike, duke siguruar që çështjet biznesore të zgjidhen me shpejtësi dhe pa zvarritje që dëmtojnë kapitalin.

Kthimi i dinjitetit dhe pavarësisë së gjyqësorit: Do të garantojmë mbrojtje të plotë të institucioneve të drejtësisë nga ndërhyrjet politike, duke siguruar ekzekutim të prerë të vendimeve gjyqësore për të garantuar pacenueshmërinë e pronës dhe investimeve.

Lufta ndaj klientelizmit dhe monopoleve: Do të zbatojmë kode të avancuara të etikës dhe transparencës në prokurimin publik, duke thyer monopolet ekonomike dhe duke krijuar konkurrencë të ndershme e të barabartë për të gjithë akterët në treg.

Fuqizimi i institucioneve të pavarura: Do të rritet pavarësia financiare dhe operacionale e institucioneve mbikëqyrëse, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm, Avokatin e Popullit dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

3. Digjitalizimi, Transparenca dhe Identiteti Digjital

Platforma Kombëtare për Transparencë në Qeverisje: Do të krijojmë një platformë digjitale të hapur, ku çdo qytetar dhe biznes mund të monitorojë shpenzimet publike, kontratat e prokurimit dhe projektet e qeverisë në kohë reale.

Avancimi i E-Qeverisjes: Do të digjitalizojmë të gjitha shërbimet administrative për bizneset dhe qytetarët, duke reduktuar kontaktin fizik me zyrtarët, gjë që eliminon potencialin për korrupsion dhe korrigjon vonesat burokratike.

Menaxhimi i domenit shtetëror (".kos"): Do të themelojmë një Qendër Kombëtare të Pavarur për menaxhimin dhe regjistrimin e domeneve të nivelit të lartë, duke siguruar kontrollin e plotë mbi domenin ".kos" për të mbrojtur identitetin dhe sigurinë digjitale të Republikës së Kosovës.

Digjitalizimi i administratës publike: Do të ndërtojmë sisteme të integruara elektronike për komunikim institucional, arkivim digjital dhe ofrim të shërbimeve publike pa burokraci të panevojshme.

Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat

4. Fuqizimi i Institucioneve të Pavarura dhe Partneriteti

Konsultime të rregullta institucionale: Do të instalohet një praktikë e detyrueshme e konsultimit paraprak me shoqërinë civile, mediat, partnerët socialë dhe odat ekonomike përpara miratimit të çdo ligji me interes ekonomik apo publik.

Trajnimi profesional dhe depolitizimi i administratës: Do të zhvillohet trajnim i vazhdueshëm profesional për nëpunësit publikë dhe do të garantohet siguri juridike për administratën profesionale, të pavarur nga ndikimet partiake.

Partneriteti Qendror-Lokal: Do të rrisim bashkëpunimin dhe transferet financiare drejt komunave, duke mbështetur projektet lokale që vlerësojnë drejtpërdrejt performancën administrative dhe nevojat reale të bizneseve në terren.

Mbrojtja e lirisë së medies dhe shoqërisë civile: Do të krijohen mekanizma të pavarur për mbështetjen e projekteve të mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, duke garantuar pavarësinë e tyre nga ndikimi politik dhe ekonomik.

5. Bujqësia Moderne, Agropërpunimi dhe Zhvillimi Rural

Politika Tatimore për Tokën Bujqësore: Toka bujqësore që punohet dhe vihet në funksion të prodhimit nuk do të tatohet, ndërsa toka që lihet e papunuar pa arsye do t'i nënshtrohet tatimit progresiv, me qëllim aktivizimin e potencialit prodhues, rritjen e shfrytëzimit të tokës dhe stimulimin e prodhimit vendor.

Trefishimi i financimit për bujqësinë: Do të rrisim ndjeshëm mbështetjen financiare për fermerët përmes subvencioneve direkte, kredive të buta dhe fondeve të posaçme për modernizimin e fermave, mekanizimit dhe prodhimit vendor.

Investime strategjike në ujitje dhe infrastrukturë rurale: Do të investohen mbi 100 milionë euro në sistemet moderne të ujitjes, infrastrukturën bujqësore dhe lidhjen e zonave rurale me tregun, me qëllim rritjen e prodhimit dhe stabilitetit të sektorit.

Mbështetje për agropërpunimin dhe industrinë ushqimore: Do të krijohen lehtësira fiskale për industritë e reja agropërpunuese, duke përfshirë heqjen e tatimit në fitim për katër vitet e para, mbështetje për paketim, ambalazhim dhe standardizim të produkteve ushqimore sipas standardeve evropiane.

Heqja e akcizës së naftës për bujqësinë: Do të eliminojmë barrën shtesë financiare për fermerët përmes heqjes së akcizës së naftës që përdoret në sektorin bujqësor dhe prodhues.

Rritja e konkurrueshmërisë dhe eksportit: Do të mbështesim fuqizimin e njësive agro-ekonomike, zhvillimin e prodhimit sekondar dhe krijimin e një zinxhiri të qëndrueshëm ushqimor që ul varësinë nga importi dhe rrit eksportin vendor.

Zgjidhja e çështjeve pronësore në zonat rurale: Do të përshpejtojmë regjistrimin e pronave dhe zgjidhjen e kontesteve pronësore për të krijuar siguri juridike për investime në bujqësi, përpunim dhe turizëm rural.

Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat

Trajnimi dhe edukimi i fermerëve: Do të organizohen programe të vazhdueshme trajnimi profesional për fermerët në fushën e prodhimit modern, menaxhimit të fermave, standardeve ushqimore dhe përdorimit të teknologjisë në bujqësi.

Programi "Eksploro Fermerin": Do të zhvillojmë turizmin rural si burim të ri ekonomik për familjet në fshat, duke promovuar produktet vendore, gastronominë, traditën dhe potencialin natyror të Kosovës.

6. Teknologjia, Inovacioni dhe Ekonomia Digjitale

Avancimi i e-Qeverisjes dhe shërbimeve digjitale: Do të digjitalizojmë shërbimet publike për qytetarët dhe bizneset me qëllim uljen e burokracisë, rritjen e transparencës dhe përshpejtimin e procedurave administrative.

Platforma Kombëtare për Transparencë: Do të ndërtojmë platformë shtetërore për monitorimin në kohë reale të shpenzimeve publike, projekteve kapitale dhe kontratave të prokurimit.

Zhvillimi i ekonomisë digjitale dhe start-up-eve: Do të krijojmë politika fiskale dhe financiare për mbështetjen e start-up-eve teknologjike, inovacionit dhe shërbimeve digjitale me potencial eksporti dhe punësimi cilësor për të rinjtë.

5.

Brain Hub dhe kapitali njerëzor: Do të krijojmë platformën "Brain Hub" për lidhjen e ekspertëve vendorë dhe diasporës në TIK, Inteligjencë Artificiale, siguri kibernetike dhe fusha deficitare strategjike.

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në administratë: Do të përdorim Inteligjencën Artificiale për analizë të të dhënave, përmirësim të shërbimeve publike dhe rritje të efikasitetit institucional, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave dhe standardet demokratike.

Sovraniteti digjital dhe infrastruktura shtetërore: Do të ndërtojmë infrastrukturë të pavarur për domenet shtetërore, identitetin digjital dhe sistemet publike të të dhënave për të garantuar siguri dhe autonomi teknologjike.

Partneriteti publik-privat në teknologji: Do të forcojmë bashkëpunimin mes shtetit, sektorit privat, sistemit bankar dhe operatorëve teknologjikë për zhvillimin e rrjeteve moderne dhe shërbimeve të avancuara digjitale.

7. Turizmi, Kultura dhe Ekonomia Kreative

Zhvillimi i turizmit dhe fshatrave turistike: Do të zhvillojmë projekte për 20 fshatra me potencial turistik dhe programe të turizmit rural që lidhen me gastronominë, trashëgiminë kulturore dhe produktet vendore.

Paketa turistike Kosovë–Shqipëri: Do të ndërtojmë ofertë të përbashkët turistike dhe promovuese me Shqipërinë për ta lidhur Kosovën me tregun rajonal dhe ndërkombëtar të turizmit.

Nation Branding dhe promovimi ndërkombëtar: Do të hartojmë strategji shtetërore të Nation Branding për promovimin e Kosovës si vend demokratik, kreativ, mikpritës dhe me potencial ekonomik, turistik e kulturor.

Zhvillim Ekonomik, Drejtësi Efikase dhe Partneritet me Sektorin Privat

Kultura si industri kreative: Do të mbështesim filmin, kinematografinë, festivalet, ekspozitat dhe aktivitetet kulturore tradicionale si pjesë të ekonomisë kreative dhe përfaqësimit ndërkombëtar të Kosovës.

Mbështetje për artistët dhe të rinjtë kreativë: Do të krijojmë fonde të posaçme për projektet artistike të grave të reja dhe të rinjve të talentuar në kulturë, art dhe industri kreative.

Muzetë dhe trashëgimia kulturore: Do të mbështesim ndërtimin e muzeve historike dhe promovimin e trashëgimisë kulturore si pjesë e identitetit shtetëror dhe zhvillimit të turizmit kulturor.





Siguri Energjetike dhe Infrastrukturë Moderne

ENERGJI

Siguri Energjetike dhe Infrastrukturë Moderne

Energjia dhe infrastruktura nuk janë thjesht çështje teknike; ato janë shtyllat e sigurisë kombëtare dhe pavarësisë ekonomike të Republikës së Kosovës. Për një kohë të gjatë, mungesa e një vizioni strategjik, revitalizimi i pamjaftueshëm i KEK-ut, refuzimi i projekteve të gazit gjeopolitik dhe ngecja e investimeve kapitale në infrastrukturë e kanë lënë Kosovën të varur nga importi i shtrenjtë dhe nga krizat sezonale. Energjia e pasigurt dhe rrjeti i vjetruar rrugor janë kthyer në një taksë të fshehtë që po rëndon standardin e jetesës së familjeve dhe po dëmton rëndë konkurrueshmërinë e sektorit privat.

Aleanca do të zbatojë një qasje sovrane për tranzicionin energjetik dhe integrimin logjistik, duke garantuar furnizim të qëndrueshëm, çmime të parashikueshme dhe infrastrukturë moderne që ul koston e transportit për prodhuesit tanë.

Për mandatin qeverisës 2026–2030, ne zotohemi për këto masa dhe projekte konkrete:

1. Pavarësia Energjetike dhe Modernizimi i KEK-ut

Plani Strategjik për KEK-un: Do të zbatojmë një reformë të thellë teknike dhe menaxheriale në Korporatën Energjetike të Kosovës, duke eliminuar keqmenaxhimin dhe kaosin financiar përmes udhëheqjes profesionale të pavarur.

Modernizimi i kapaciteteve bazë: Do të investojmë në revitalizimin rrënjësor të blloqeve ekzistuese të termocentraleve me teknologji të avancuar që ul emetimet dhe rrit efikasitetin, duke siguruar një kapacitet të qëndrueshëm deri në 500 MW si bazë e sistemit.

Ndërtimi i Termocentralit të Ri: Me qëllim të garantimit të pavarësisë absolute energjetike të vendit dhe mbrojtjes së industrisë nga krizat globale, Aleanca do të nisë projektin për ndërtimin e një termocentrali të ri me qymyr me teknologjinë më të avancuar mjedisore.

Rikthimi i Projektit të Gazit: Do të rinisim menjëherë projektimin gjeostrategjik për ndërtimin e interkoneksionit të gazsjellësit me Maqedoninë e Veriut (lidhja me gazsjellësin TAP), duke integruar rrjetin e gazit si burim kyç për industrinë dhe diversifikimin energjetik.

Integrimi i Tregut me Shqipërinë: Do të funksionalizojmë në plotëni tregun e përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri (ALPEX), duke shfrytëzuar natyrën komplementare të burimeve tona (termike dhe hidrike) për të evituar blerjet e shtrenjta gjatë pikave të krizës.

2. Diversifikimi, Efiçienca dhe Lehtësimi i Tarifave

Zhvillimi i Energjisë së Ripërtëritshme: Do të liberalizojmë tregun për investimet private në energji solare dhe të erës, duke krijuar një miks të qëndrueshëm energjetik dhe duke zhvilluar kapacitetet e energjisë gjeotermale.

Ngrohja Qendrore me Biomasë: Do të ndërtojmë 7 qendra të reja të ngrohjes qendrore me biomasë në komunat ku ekziston potenciali lokal, duke hequr një barrë të madhe të konsumit nga rrjeti elektrik gjatë dimrit.

Programi Nacional për Efiçiencë: Do të rrisim fondin shtetëror për izolimin e objekteve publike, shkollave, spitaleve dhe shtëpive private, duke reduktuar direkt humbjet teknike dhe faturat e qytetarëve.

Siguri Energjetike dhe Infrastrukturë Moderne

Ulja e TVSH-së në 6%: Do të ulim normën e TVSH-së për energjinë elektrike nga 8% në 6% për të gjithë konsumatorët familjarë, si masë e menjëhershme kundër shtrenjtimit të jetesës.

Tarifa Sociale e Mbrojtur: Do të reformojmë metodën e tarifimit duke garantuar një tarifë të reduktuar dhe të subvencionuar për familjet e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të UÇK-së dhe familjet në asistencë sociale.

Pavarësia e ZRRE-së: Do të garantojmë pavarësi të plotë ligjore për Zyrën e Rregullatorit për Energji, duke siguruar vendimmarrje transparente që mbron konsumatorin nga shtrenjtimet e pakontrolluara.

3. Infrastruktura Moderne dhe Lidhjet Logjistike

Përmbyllja e Korridoreve Rrugore: Do të përfundojmë me prioritet të lartë dhe brenda dy viteve të para të gjitha autostradat dhe akset rrugore kombëtare të mbetura peng i premtimeve (Prishtinë-Podujevë, Prishtinë-Gjilan, Prishtinë-Mitrovicë dhe rrugën e Gjakovës).

Infrastruktura si instrument ekonomik: Do të riorientojmë investimet kapitale drejt nyjeve logjistike dhe lidhjeve me zonat industriale, duke ulur koston e transportit të mallrave për prodhuesit tanë.

Modernizimi i Rrjetit Hekurudhor: Do të përshpejtojmë projektet për rehabilitimin e linjave hekurudhore që lidhin Kosovën me rrjetet tranzit evropiane përmes Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, duke krijuar alternativa më të lira për transportin industrial.

4. Infrastruktura Moderne, Transporti Publik dhe Lidhja Rajonale

Përmbyllja e autostradave dhe akseve strategjike: Do të realizojmë autostradën e Dukagjinit dhe do të përfundojmë me prioritet segmentet Prishtinë-Merdare, Prishtinë-Gjilan, Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-Podujevë, Dollc-Gjakovë dhe Gjilan-Konçul, duke i kthyer ato në korridore zhvillimore ekonomike.

Zhvillimi i rrugëve rajonale dhe lokale: Do të investojmë në rrugët Kijevë-Zahaq-Prishtinë-Pejë, Deçan-Plavë dhe Komoran-Drenas-Skenderaj, si dhe në rrugë lokale në bashkëfinancim me komunat, me qëllim përmirësimin e qasjes në shërbime, treg dhe punësim.

Modernizimi i transportit hekurudhor: Do të ndërtojmë hekurudhën Prishtinë-Durrës dhe linjën hekurudhore Aeroporti Adem Jashari-Prishtinë, si dhe do të rehabilitojmë rrjetin ekzistues hekurudhor për ta lidhur Kosovën me korridoret rajonale dhe tregjet evropiane.

Transport publik në të gjitha vendbanimet: Do të investojmë në transport publik funksional dhe të qasshëm në të gjitha komunat dhe vendbanimet e Kosovës, duke ulur izolimin, kostot për familjet dhe ndotjen në qytete.

Infrastruktura si politikë zhvillimore: Investimet kapitale do të lidhen drejtpërdrejt me zonat ekonomike, prodhimin vendor, bujqësinë, turizmin dhe zhvillimin rajonal, në mënyrë që çdo projekt infrastrukturor të prodhojë ndikim ekonomik dhe vende pune.

Siguri Energjetike dhe Infrastrukturë Moderne

Lidhja ekonomike me Shqipërinë dhe rajonin: Do të forcojmë lidhjet tregtare dhe logjistike me Shqipërinë dhe vendet partnere përmes projekteve infrastrukturore dhe heqjes së pengesave për shkëmbime ekonomike, tregtare dhe kulturore.

Partneriteti publiko-privat për projekte strategjike: Do të përdorim modelin e partneritetit publiko-privat për realizimin e projekteve infrastrukturore me potencial ekonomik dhe shoqëror, duke garantuar transparencë dhe përfitim publik afatgjatë.

5. Mjedisi, Uji dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

Siguria ujore dhe infrastruktura e ujit: Do të investojmë në diga, rezervuarë, rrjete të ujitjes dhe sisteme moderne të menaxhimit të ujërave atmosferike dhe ujërave të zeza për të garantuar furnizim të qëndrueshëm dhe mbrojtje nga krizat klimatike.

Trajtimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza: Do të ndërtohen impiante moderne për trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave në nivel rajonal, duke ulur ndotjen e lumenjve dhe rrezikun për shëndetin publik.



Reduktimi i ndotjes industriale dhe ajrore: Do të modernizojmë kapacitetet energjetike ekzistuese dhe do të zbatojmë standarde më të larta mjedisore për industrinë dhe operatorët ekonomikë, me qëllim uljen graduale të emetimeve ndotëse.

Tranzicioni energjetik dhe dekarbonizimi: Do të hartojmë plan afatgjatë për dekompozimin e kapaciteteve të vjetra ndotëse dhe kalimin gradual drejt energjisë së pastër dhe burimeve të ripërtëritshme.

Mbrojtja e biodiversitetit dhe hapësirave natyrore: Do të forcojmë mbrojtjen e pyjeve, lumenjve dhe zonave të mbrojtura natyrore si pjesë e sigurisë ekologjike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.



Edukimi Profesional dhe Lidhja e Arsimit me Tregun

ZHVILLIM

Edukimi Profesional dhe Lidhja e Arsimit me Tregun

Arsimi dhe aftësimi profesional janë themelet kryesore të zhvillimit afatgjatë dhe të ruajtjes së kapitalit njerëzor në Kosovë. Një sistem arsimor që nuk i përgatit nxënësit dhe studentët për ekonominë reale prodhon papunësi kronike, pakënaqësi dhe emigrim masiv të të rinjve. Aleanca do të udhëheqë një reformë rrënjësore dhe reale të cilësisë, duke e zhvendosur sistemin nga logjika formale e prodhimit të diplomave pa mbulesë drejt prodhimit të aftësive praktike dhe profesionistëve realë.

Ne do ta kthejmë shtetin në financuesin dhe mbështetësin kryesor të edukimit që lidhet drejtpërdrejt me nevojat e sektorit privat, duke u fokusuar në sektorët me potencialin më të lartë të rritjes: energji, teknologji e informacionit (TIK), prodhim, ndërtim, industri agro-përpunuese, shëndetësi dhe eksport.

Përgatitja e kuadrove në teknologji, Inteligjencë Artificiale dhe siguri kibernetike do të jetë prioritet strategjik i sistemit arsimor dhe profesional. Aleanca do të lidhë universitetet, shkollat profesionale dhe sektorin privat për krijimin e profileve që kërkohen nga tregu modern i punës dhe ekonomia digjitale globale.

Për mandatin qeverisës 2026–2030, Aleanca zotohet për realizimin e këtyre masave konkrete:

1. Arsimi Profesional dhe Jetësimi i Modelit Dual

Financimi i Modelit Dual Evropian: Do të reformojmë tërësisht arsimin e mesëm profesional duke zbatuar modelin e kombinuar: mësim teorik në shkolla dhe punë praktike e paguar drejtpërdrejt nëpër biznese, ku shteti merr përsipër paketën stimuluese të subvencionimit.

Degë të Arsimit të Lartë Profesional: Në partneritet publiko-privat me kompanitë e mëdha dhe odat ekonomike, do të krijojmë kolegje dhe degë të larta profesionale të bazuara ekskluzivisht në kërkesat e tregut të punës.

Formimi Profesional në Zonat Rurale: Do të zgjerojmë rrjetin e shkollave dhe kurseve profesionale nëpër fshatra e zona rurale, duke ofruar kualifikime specifike në bujqësi moderne, agropërpunim, menaxhim të fermave dhe shërbime bujqësore.

Kualifikimi i Punëkërkuesve të Regjistruar: Do të zbatojmë një program të detyrueshëm kombëtar për trajnimin dhe rikualifikimin e të gjithë punëkërkuesve të regjistruar nëpër zyrat e punësimit, duke synuar përgjysmimin e papunësisë te gratë dhe vajzat brenda mandatit.

Gjithëpërfshirja në Tregun e Punës: Do të dizajnojmë programe, certifikime dhe kurse kualifikuese të përshtatura posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara, duke u garantuar atyre qasje reale në punësim.

2. Dinjiteti i Mësimdhënësve dhe Cilësia në Arsimin Parauniversitar

Paga Dinjitoze dhe Meritokraci: Do të sigurojmë rritje dhe indeksim të rregullt vjetor të pagave për punëtorët e arsimit në të gjitha nivelet përmes ngritjes së vlerës së koeficientit, duke e lidhur atë me performancën, trajnimet e avancuara dhe shkallën e inflacionit.

Infrastruktura dhe Digjitalizimi i Shkollave: Do të përmirësojmë infrastrukturën fizike të shkollave sipas kritereve bashkëkohore dhe do të investojmë në digjitalizimin e plotë të klasave (kabinete të TIK-ut, laboratorë shkencorë dhe mjete digjitale të mësimdhënies).

Edukimi Profesional dhe Lidhja e Arsimit me Tregun

Siguria në Shkolla: Do të hartojmë një protokoll të ri kombëtar të sigurisë në shkolla, duke investuar në sisteme monitorimi, personel të specializuar të sigurisë dhe mbështetje psikologjike për të krijuar një ambient plotësisht të sigurt për nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit.

Edukimi i Hershëm Parashkollor: Do të rrisim buxhetin shtetëror për ndërtimin e çerdheve të reja publike dhe mbështetjen e ofruesve joqeveritarë, me qëllim që çdo fëmijë në Kosovë të ketë qasje të barabartë në edukimin e hershëm para moshës 5-vjeçare.

3. Autonomia e Universiteve dhe Arsimi në Diasporë

Depolitizimi dhe Autonomia e Universiteteve: Do të largojmë ndikimin politik nga universitetet publike, duke u rikthyer atyre autonominë e plotë akademike, menaxheriale dhe lirinë e kërkimit shkencor.

Profilizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë: Do të ndryshojmë modelin e financimit të universiteteve publike duke i profilizuar ato sipas nevojave strategjike të rajoneve ku veprojnë, me qëllim rritjen e pavarësisë së tyre financiare dhe lidhjen me inovacionin.

Rregullimi Ligjor i Arsimit në Diasporë: Do të miratojmë Ligjin e veçantë për Arsimin Plotësues në Diasporë, duke financuar direkt nga buxheti i Kosovës tekstet shkollore, trajnimin e mësuesve në mërgatë dhe platformat digjitale të mësimit të gjuhës dhe historisë shqipe.

4. Dialogu Trepalësh dhe Agjencia e Punës

Rikthimi i Kulturës Trepalëshe: Do të rihapim dialogun institucional mes shtetit, sindikatave të arsimit/punëtorëve dhe asociacioneve të bizneseve për të harmonizuar politikat e pagave, të drejtave në punë dhe përfitimeve sociale.

Reformimi i Agjencisë së Punës: Agjencia e Punës do të shndërrohet në një instrument kyç proaktiv që monitoron lëvizjet e tregut në kohë reale, duke udhëzuar shkollat dhe universitetet se cilat profile duhen hapur apo mbyllur çdo vit akademik.





Rritje Ekonomike si Bazë për Politikën Sociale

ZHVILLIM

Rritje Ekonomike si Bazë për Politikën Sociale

Mirëqenia sociale dhe stabiliteti i familjes janë treguesit kryesorë nëse Kosova po shndërrohet në një shtet të jetueshëm me dinjitet. Aleanca refuzon praktikën e trajtimit të skemave sociale dhe pensioneve si mjete për varësi afatgjatë politike. Mbështetja sociale e qëndrueshme nuk mund të vijë pa zgjerim të ekonomisë dhe pa rritje të të hyrave reale buxhetore.

Ne do ta vendosim familjen dhe punësimin produktiv në qendër të politikës publike. Ky investim strategjik synon të mbrojë kuletën e qytetarit nga inflacioni, të ndalojë emigrimin masiv të të rinjve dhe të krijojë mundësi të barabarta për gratë dhe shtresat më të ndjeshme të shoqërisë, duke u ofruar paketa punësimi dhe dinjitet institucional.

Për mandatin qeverisës 2026–2030, Aleanca zotohet për realizimin e këtyre masave konkrete:

1. Dinjiteti i Pensionistëve dhe Mbrojtja e Vlerave të Luftës

Rritja Progresive e Pensioneve drejt 500 Eurove: Aleanca vlerëson se me shtrenjtimin drastik të çmimeve dhe kostos së jetesës, pragu prej 500 eurosh është kufiri minimal për të garantuar një jetë me dinjitet për pensionistët tanë. Për ta jetësuar këtë standard në mënyrë të qëndrueshme, ne do të vendosim një dysheme të menjëhershme fillestare: pensioni bazik i moshës ngritet në 250 euro, ndërsa pensioni kontributpagues në 400 euro. Mbi këtë bazë, përmes ligjit të ri, këto vlera do të ngriten në mënyrë progresive çdo vit me synim që asnjë pensionist në Kosovë të mos ketë të ardhura nën 500 euro.

Indeksimi i detyrueshëm ndaj Inflacionit: Të gjitha pensionet do të rriten çdo vit në mënyrë automatike sipas indeksit të zhvillimit ekonomik dhe shkallës së inflacionit, duke garantuar që paratë e të moshuarve të mos humbin vlerën blerëse nga shtrenjtimi i çmimeve në markete.

Barazimi i Pensionit të Veteranit me 500€: Do të miratojmë me urgjencë plotësim-ndryshimin e ligjit për vlerat e luftës, duke garantuar barazimin e pensionit të veteranit të UÇK-së me pragun e pagës minimale prej 500 euro, duke iu ofruar familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve mbështetje reale që mbron dinjitetin e tyre.

Infrastruktura e Kujdesit për të Moshuarit: Do të financojmë ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrave Moderne të Pensionistëve në secilën komunë të Kosovës, për shërbime të integruara shëndetësore primare dhe sociale.

2. Politikat Kombëtare për Familjen dhe Parandalimin e Emigrimit

Agjenda e Mirëqenies Familjare: Do të krijojmë Departamentin Kombëtar për Familjen, i cili do të koordinojë politikat e punësimit, banimit, arsimit dhe shëndetësisë për mbrojtjen e bërthamës familjare.

Subvencionimi i Kredive për Çiftet e Reja: Për të ndalur emigrimin, do të jetësojmë një program të ri banimi përmes partneriteteve publiko-private ku shteti subvencionon deri në 50% të kamatës së kredisë për shtëpinë apo banesën e parë për çiftet e reja.

Rritje Ekonomike si Bazë për Politikën Sociale

Pakoja Mbështetëse për Nënat dhe Fëmijët: Do të reformojmë skemën e shtesave për fëmijë duke i rritur ato në mënyrë progresive për familjet që kanë të ardhura nën pagën minimale, si dhe do të garantojmë mbështetje të veçantë financiare për lehonat e papunësuara.

Fondi për Kthimin e Rinisë dhe Ndërmarrësinë: Do të krijojmë grante të veçanta për të rinjtë që hapin biznese prodhuese në Kosovë dhe pako stimuluese për integrimin e kapitalit të mërgatës në projekte vendore.

Mbrojtja nga Dhuna dhe Dukuritë Negative: Do të hartohet një strategji kombëtare ndërinstitucionale kundër dhunës në familje, duke themeluar qendra këshillimi dhe strehimi në çdo rajon.

3. Agjencia e Punësimit dhe Fuqizimi i Tregut të Punës

Agjencia Kombëtare e Punësimit: Do të themelojmë këtë mekanizëm me kompetenca të plota ekzekutive pranë Zyrës së Kryeministrit për të modernizuar zyrat e punës nëpër komuna dhe për të ndërlidhur në kohë reale punëkërkuesit me bizneset.

Përgjysmimi i Papunësisë te Gratë: Do të ndërtojmë programe të targetuara të aftësimit dhe trajnimit brenda vitit të parë për të gjitha gratë e regjistruara si punëkërkuese, duke ofruar lehtësime të barrës administrative apo taksave për bizneset që i punësojnë ato.

Kuota të Detyrueshme për Personat me Aftësi të Kufizuara: Do të miratojmë ligjin e ri për vlerësimin dhe njohjen e statusit, duke zbatuar gjoba dhe stimuj të rreptë financiarë për sektorin publik dhe privat për të garantuar punësimin e tyre real.

Zbatimi i Kontratës Kolektive: Do të ndajmë buxhetin e domosdoshëm për zbatimin e plotë të Kontratës Kolektive të bllokuar prej vitesh dhe do të rikthejmë dialogun social trepalësh (Shtet - Biznes - Sindikatë).

4. Sporti, Rinia dhe Aktivizimi Kulturor

Infrastruktura sportive moderne: Do të finalizojmë infrastrukturën për Lojërat Mesdhetare 2030 dhe do të ndërtojmë stadiume olimpike dhe gjysmë-olimpike sipas standardeve të UEFA-s dhe FIFA-s, me prioritet Stadiumin “Adem Jashari” në Mitrovicë.

Mbështetje për rininë dhe aktivitetet kulturore: Do të financojmë aktivitete sportive, kulturore dhe rinore që forcojnë jetën komunitare, zhvillojnë talentin dhe krijojnë hapësirë për përfshirje aktive të të rinjve.

Sporti si diplomaci publike: Do ta përdorim sportin dhe kulturën si instrumente të promovimit ndërkombëtar dhe të forcimit të imazhit pozitiv të Kosovës.



Shëndetësi e Siguruar dhe Shërbime me të Vërtetë Falas

SIGURI

Shëndetësi e Siguruar dhe Shërbime me të Vërtetë Falas

Shëndetësia është shtylla më e drejtpërdrejtë që përcakton sigurinë e familjes dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. Aleanca udhëhiqet nga parimi i prerë se shërimi i qytetarit nuk duhet të jetë asnjëherë më i shtrenjtë se shëndeti i tij. Për një kohë të gjatë, listat e gjata të pritjes, mungesa kronike e barnave esenciale dhe detyrimi për të paguar nga xhepi nëpër spitale private e kanë kthyer shëndetësinë në një ankth dhe burim varfërie për familjet kosovare.

Aleanca do të ndërtojë një sistem shëndetësor që mbron me dinjitet familjen kosovare, duke e kthyer Fondin e Sigurimeve Shëndetësore në një realitet të prekshëm që në vitin e parë të qeverisjes sonë. Ne do të heqim çdo tarifë bazë dhe çdo participim nëpër sportele.Përmes këtij modeli modern, asnjë qytetar nuk do të detyrohet të paguajë apo të blejë vetë barnat esenciale gjatë mjekimit të tij.
Aleanca garanton shërbime të plota, barna falas dhe pa asnjë pagesë në sportele për çdo familje në Kosovë.

Për mandatin qeverisës 2026–2030, Aleanca zotohet për realizimin e këtij plani operacional:



1. Preventiva Kombëtare

Kontrolla sistematike, skanim (screening) për kancer, diabet e sëmundje kardiake, dhe edukim shëndetësor.
Riorientim i buxhetit ekzistues: 2–3% nga shpenzimet spitalore kalojnë në preventivë. Financimi mbështetet në kursimet e krijuara nga ulja e hospitalizimeve të rënda dhe përmes Partneriteteve Publiko-Privat (PPP) për shërbimet e screening-ut.

Përmes një sistemi elektronik qendror që fton automatikisht pacientët për kontrolle. Qendrat e Mjekësisë Familjare (QKMF) bëhen pikat kryesore ekzekutive, duke aplikuar kontrata me indikatorë: "sa më shumë zbulim i hershëm = më shumë financim".

2. Reforma Spitalore dhe Decentralizimi

Fuqizim i Spitaleve Rajonale të specializuara, pajisje moderne diagnostike në çdo qendër, dhe rritje e kapaciteteve të kirurgjisë ditore për të ulur presionin dhe pritjet në QKUK.
Si financohet: Fazim i investimeve kapitale për një periudhë 5–7 vjeçare, huamarrje të huaja të dedikuara ekskluzivisht për investime në pajisje (CAPEX), dhe fonde zhvillimore nga BE. Ndalimi i referimeve të pacientëve jashtë vendit do të kthehet në kursim direkt për buxhetin e shtetit.
Çdo spital rajonal do të marrë një "profil" të qartë (kirurgji, internistikë, diagnostikë). Menaxhimi do të bëhet përmes Indikatorëve Kyç të Performancës (KPI) për sukses financiar e mjekësor, duke lejuar kontrata publike me operatorët privatë për shërbime specifike e të shpejta.

Shëndetësi e Siguruar dhe Shërbime me të Vërtetë Falas

3. Kujdesi Parësor dhe Mjekësia Familjare

Çfarë bëhet: Implementim i plotë i mjekësisë familjare përmes zonimit të saktë dhe krijimit të listave të pacientëve. Mjeku familjar do të shërbejë si filtër, i mbështetur nga laboratorë bazikë në çdo pikë dhe digjitalizim të plotë. Stomatologjia do të kalojë plotësisht në sektorin primar.

Rishpërndarje e mjeteve nga niveli spitalor (ulja e ngarkesës në spitale sjell kursim direkt). Krijojmë një Fond Kombëtar për Kujdesin Parësor dhe aplikojmë sistemin e pagesës sipas shërbimit dhe performancës (pay-per-performance).

Pacientët do të pajisen me Kartelën Elektronike Unike. Sistemi i referimit nga mjeku primar te specialisti do të bëhet plotësisht digjital (pa leta), ndërsa mjekët familjarë do të kenë targeta të matshme të kontrollit dhe diagnostikimit.

4. Menaxhimi i Barnave dhe Lista Esenciale

Zgjerim radikal i Listës Esenciale të Barnave, ulje e çmimeve në treg dhe ndalim i praktikës ku pacienti blen vetë materialet gjatë mjekimit përmes zbatimit të recetës elektronike.

Blerje e centralizuar shtetërore e cila ul me 20–40% koston e furnizimit. Do të aplikojmë tenderë ndërkombëtarë transparentë, duke hequr TVSH-në për barnat dhe duke kufizuar markat e shtrenjta komerciale aty ku ekzistojnë barna gjenerike të të njëjtit kualitet.

Implementojmë Sistemin Elektronik të Barnave, i cili mundëson gjurmimin në kohë reale të medikamentit, nga importi në doganë e deri te pacienti. Nënshkruajmë kontrata afatgjatë me kompani të mëdha farmaceutike dhe vendosim kontroll automatik ndaj abuzimeve.

5. Digjitalizimi (TIK)

Funksionalizim i plotë i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), duke integruar Kartelën Elektronike të Pacientit për të eliminuar abuzimet me barna dhe për të përshpejtuar shërbimin.

Investimi fillestar kapital (CAPEX) do të mbulohet nga një Fond i posaçëm IT i buxhetit të shtetit, i ndihmuar nga donacionet teknologjike ndërkombëtare, duke sjellë ulje drastike të kostove administrative në afatgjatë.

Përmes një platforme qendrore shtetërore e cila integron të gjitha institucionet mjekësore (publike dhe private), e mbrojtur nga një sistem i fortë i sigurisë kibernetike.

6. Personeli Shëndetësor (Mjekët dhe Infermierët)

Rritje e qëndrueshme e pagave dhe dinjitetit profesional. Konkurse të rregullta dhe meritokratike për specializantë me qëllim të prerë ndaljen e emigrimit të bluzave të bardha.

Si financohet: Përmes riorientimit të shpenzimeve buxhetore joefikase dhe kursimit prej 10–20% që do të vijë direkt nga luftimi i korrupsionit në furnizime mjekësore. Ndërtojmë kontrata të reja shërbimi që kombinojnë pagën bazë me performancën.

Specializantët do të nënshkruajnë kontrata të detyrueshme të shërbimit në institucionet publike pas përfundimit të shkollimit. Do të aplikojmë bonuse dhe stimuj të fuqishëm financiarë për mjekët që punojnë në zonat deficitare gjeografike, të shoqëruar me vlerësim vjetor profesional.

Shëndetësi e Siguruar dhe Shërbime me të Vërtetë Falas

7. Kujdesi Paliativ

Themeli i qendrave të veçanta paliative për trajtimin e pacientëve me sëmundje të rënda të shkallës së fundit, duke ofruar kujdes profesional në shtëpi dhe menaxhim shkencor të dhimbjes.
Ridrejtojmë 1–2% të buxhetit spitalor nga rastet e shtrenjta terminale që mbingarkojnë padrejtësisht shtretërit e spitaleve drejt kujdesit shtëpiak. Ky sistem do të mbështetet edhe në donacione humanitare dhe partneritete me OJQ.

Krijojmë Ekipet Mobile (mjek + infermier + psikolog) për vizita shtëpiake, duke zbatuar Protokollet Kombëtare për Dhimbjen dhe duke garantuar furnizim të pandërprerë med analgjezikë esencialë.

8. Shëndeti Publik dhe Mjedisor

Monitorim dhe mbrojtje e cilësisë së ajrit, ujit dhe ushqimit si komponentë të shëndetit publik, duke parandaluar shfaqjen e epidemive dhe sëmundjeve që vijnë nga ndotja e mjedisit.
Përmes buxhetit të rregullt shtetëror, fondeve mjedisore ndërkombëtare dhe duke krijuar një fond të dedikuar që mbushet drejtpërdrejt nga gjobat dhe taksat mjedisore ndaj ndotësve të mëdhenj.
Fuqizojmë Agjencinë Kombëtare të Monitorimit, duke zbatuar inspektime digjitale në terren dhe duke ndërtuar laboratorë referentë shtetërorë për kontrollin e rreptë të ushqimeve që importohen.

9. Shëndeti Mendor

Rritje e pranisë së psikologëve në të gjitha shkollat e Kosovës, hapje e qendrave rajonale të këshillimit, dhe funksionalizim i një linje telefonike emergjente kombëtare për mbështetje psikologjike.
Shërbimi integrohet tërësisht brenda rrjetit ekzistues të kujdesit primar (QKMF) për të mos krijuar një sistem të ri e të shtrenjtë të ndarë, duke u financuar nga një fond i përbashkët social dhe arsimor.
Çdo QKMF në Kosovë do të ketë shërbimin e integruar të shëndetit mendor, me sistem të referimit automatik për rastet e rënda dhe duke zbatuar Programin Nacional për luftimin e varësive (narkotikëve) dhe depresionit.

10. Implementimi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor

Aleanca do të kalojë me urgjencë në faze operative të mbledhjes së premiumit të sigurimit të detyrueshëm (1.5% - 2.5% për të punësuarit dhe punëdhënësit) që në vitin e parë. Ky fond do të shërbejë si motori financiar që financon Paketën e Përfitimeve për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim, duke garantuar se asnjë familje nuk do të falimentojë për t'u shëruar.

AAK 128

Falemnderit

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS


SIGURI
ENERGJI
ZHVILLIM